



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

---

V E N D I M

Nr. 51, datë 6.9.2017

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR  
DËME, TË SHKAKTUARA NGA ZJARRI**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 9 pika 1.1 shkronja “b”, 40, nenin 54 shkronja “dh”, nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika III/1/ shkronja “ë” të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore“, udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr.8, datë 30.1.2017 “Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017”, me 28 vota pro,

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Prek Docaj**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 5 (pesë) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **100,000** (njëqind mijë) lekë.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Mark Maci**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 5 (pesë) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **100,000** (njëqind mijë) lekë.
3. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Ndoc Stenaj**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
4. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Dritan Stenaj**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij



- përbëhet prej 3 (tre) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **60,000** (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
5. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Bashkim Stenaj**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
  6. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Martin Ftoni**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 5 (pesë) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **100,000** (njëqind mijë) lekë.
  7. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Ndue Kosteri**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
  8. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Arjan Kosteri**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 4 (katër) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **80,000** (tetëdhjetë mijë) lekë.
  9. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Kole Kosteri**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
  10. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Kole Shporja**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 6 (gjashtë) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **100,000** (njëqind mijë) lekë.
  11. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Jetmir Shporja**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
  12. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Zef Shporja**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
  13. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së znj. **Rozina Gjergji**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e saj përbëhet prej 6 (gjashtë) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **100,000** (njëqind mijë) lekë.
  14. Burimi i financimit do të jetë fondi i ndryshuar në programin 10910 “Emergjencat Civile”, në buxhetin e bashkisë Shkodër në programin P13, F1 O2 A1 “Transferime për individë”.

15. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës prej 880.000 (tetëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
16. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë
17. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 6.9.2017

Shpallur në datën 7.9.2017



**Sekretar i këshillit**

**Suel Hadri**

**KRYETAR**

**Xhemal BUSHATI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Pr. 14057 21.9.2017

Nr. 955/2 Prot

Shkodër, më 18.09.2017

**Lënda:** Mbi vendimin nr.51 datë 6.09.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr.107/2016, dt 27.10.2016 "Për Prefektin", neni 8, germa a, analizoi vendimin Nr.51 datë 6.09.2017 të Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe: "Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme të shkaktuara nga zjarret në shumën totale prej 880.000 lekësh, marrë nga fondi i ndryshuar në programin 10910 "Emergjencat civile", në programin P13,F1 O 2A1 "Transferime për individë" :

- Prek Docaj ne shumen 100.000 leke
- Mark Maci ne shumen 100.000 leke
- Ndoc Stenaj ne shumen 40.000 leke
- Dritan Stenaj në shumën 60.000 leke
- Bashkim Stenaj ne shumen 40.000 leke
- Martin Ftoni ne shumen 100.000 leke
- Ndue Kosteri ne shumen 40.000 leke
- Arjan Kosteri ne shumen 80.000 leke
- Kole Kosteri ne shumen 40.000 leke
- Kole Shporja ne shumen 100.000 leke
- Jetmir Shporja ne shumen 40.000 leke
- Zef Shporja ne shumen 40.000 leke
- Rozina Gjergji ne shumen 100.000 leke

Pas shqyrtimit, Prefekti në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", neni 64, germa c, neni 54 germa dh, neni 55/3, ligjit nr.8756,dt 26.03.2001 "Per emergjencat civile", i ndryshuar, ligjit nr.9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM Nr.329 dt 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhezimit të Ministrise se Brendshme & Ministrise se Financave Nr. 263 dt.24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", shkresave se Ministrise së Brendshme nr.7007 prot dt 20.10.2016, nr.806 prot dt 8.02.2017, nr.3950 prot dt 21.06.2017, duke konsideruar prioritet dhënien e ndihmës së menjëhershme për familjet e dëmtuara, ju autorizon të procedoni, me përjashtim të dëmtuarës Rozina Gjergji (përcaktuar ne VKB) apo z.Gjok Gjergji sipas aktit të

PMNZSH-se, e cila paraqet pasaktësi pasi në vendim citohet banesë, ndërsa në dokumentacionin tjetër citohet dhomë e adoptuar si dyqan, pra ushtrohet aktivitet ekonomik (të korrigojohet/të saktësohet pasi i mungon edhe procesverbali i konstatimit)


Konstatohet se nga administrata nuk zbatohen Udhëzimet e Ministrisë së Brendshme për të cituar në vendim pamundësinë financiare nga ana juaj si Bashki duke kërkuar mbështetje financiare Ministrisë së Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile) Tirane<sup>1</sup>, duke penalizuar edhe familjet e prekuara nga fatkeqesitë.

Gjithashtu nuk do t'ju lejohet të procedoni në vazhdimësi nëse nga Ju nuk zbatohet procedura sipas kreut III, pika 1, gërma "ë" e VKM nr.329/2012.

Me respekt,

P R E F E K T I

Paulin RADOVANI



---

<sup>1</sup> Bashkelidhur ju dergohet nje kopje e projekt-vendimit e derguar nga MPB edhe juve me shkresën Nr.3950 prot dt 21.06.2017.